



Republika e Kosovës/Republika Kosova/Republic of Kosovo  
Kuvendi i Kosovës/Skupstina Kosova/Assembly of Kosovo  
Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik  
Regulatorna Komisija Javne Nabavke  
Public Procurement Regulatory Commission



## UDHËZIMI ADMINISTRATIV Nr. 03/2010/KRPP

Në bazë të Nenit 82.2 (a) të Ligjit për Prokurim Publik Nr. 02/L-99 me të cilin është ndryshuar Ligji 2003/17 për Prokurimin Publik të Kosovës, shpallur më Rregulloren Nr. 2007/20, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik nxjerr këtë Udhëzim Administrativ:

### Neni 1

Qëllimi i këtij udhëzimi është të ofrojë interpretimin e ligjshmërisë së shpenzimeve të fondeve publike, në lidhje me assistencen teknike për mbikëqyrjen e projekteve tek kontratat e punës dhe kontratat e tjera.

### Neni 2

Asistenca për mbikëqyrjen e projekteve, si dhe asistenca teknike gjatë procedurave të tenderimit janë shërbime, të cilat mund të jipen vetëm pas zbatimit të njerës nga procedurat e prokurimit sipas LPP-së.

### Neni 3

Kontratat në lidhje me prokurimet publike duhet të jenë në pajtim me tenderin e dhënë në secilin rast. Kjo do të thotë se sasi shtesë të parave nuk mund të shtohen mbi shumën e paraparë në tender, të cilit i është dhënë kontrata. Kjo gjithashtu përfshin shpenzimet në lidhje me zbatimin e kontratave të tilla si shuma për mbikëqyrjen dhe monitorimin.

### Neni 4

Autoritetet kontraktuese janë të udhëzuara të raportojnë KRPP-së brenda një muaji nga data e këtij udhëzimi çdo kontratë të nënshkruar në 2010 që përmbajnë shuma të tilla shtesë duke përfshirë edhe numrin e identifikimit të prokurimit, shumën e shtuar në tender, dhe pranuesit e përcaktuar të shumës së tillë.

Prishtinë,  
22/11/2010

Kryetari i KRPP-së